



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.428/22

GJYKATA KOMERCIALE-Dhoma Shkallës së Dytë në Prishtinë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë me adresë rr. “Armend Daci” nr.1, kundër debitorit “E...” Sh.p.k me seli në Prishtinë, me nr.biznesi; ....., me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PPP.nr.233/20 i datës 18.01.2021, me datë 26.09.2022, mori këtë:

### AKTVENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit “E...” Sh.p.k me seli ne Prishtinë, dhe VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, PPP.nr.233/20 i datës 18.01.2021.

### Arsyetim

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.233/20, i datës; 18.01.2021, ka vendosur ta refuzoj si të pabazuar propësimin e debitorit “E...” Sh.p.k me seli ne Prishtinë, e paraqitur kundër aktvendimin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.379/20, i datës; 23.06.2020,i lëshuar nga Përmbaruesi privat Besnik Aliu nga Ferizaji, si dhe të mbetet në fuqi urdhëri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.379/20 i dt.23.06.2020.

Kundër këtij aktvendimi ka parashtruar ankesë debitori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike si dhe për shkak zbatimit të gabuar të së drejtës materiale,me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta pranoj ankesën si të bazuar, ta anuloj aktvendimin e ankimuar dhe të ndërpres procedurën përmbarimore.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori, duke propozuar që të refuzohet ankesa dhe aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se debitori ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me nr; 2694 të dt 13.08.2018. Përmbartuesi privat Besnik Aliu nga Ferizaji, sipas propozimit të kreditorit me urdhrin përmbartimore P.nr.379/20, të datës; 23.06.2020, ka lejuar përmbartimin duke vlerësuar se aktvendimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me nr; 2694 të dt 13.08.2018, i plotëson kushtet si vendim përmbartues i dhënë në procedurë administrative.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën;30.06.2020,Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.233/20, i datës; 18.01.2021, ka vendos që ta refuzoj prapësimin e debitorit i paraqitur kundër urdhrin përmbartimore P.nr.379/20, të datës 23.06.2020.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar së është bazuar në dokumentin përmbartimor-aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me nr; 2694 të dt 13.08.2018, i cili është formës së prerë nga data 08.11.2018, dhe i ekzekutueshëm nga data 24.11.2018, me të cilën debitorit i është shqiptuar gjoba në shumë prej 5000.00 Euro, ku dhe është detyruar që të ja paguaj kreditorit menjëherë nga pranimi i aktvendimit në xhirrollogarinë e kreditorit. Krejt në fund aktvendimin e ankimuar e ka bazuar në nenin 36 par 1 dhe 2, 27 par 1 si dhe nenin 73 par 1,2 dhe 3 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejt faktin se aktvendimi i lëshuar nga kreditori Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me nr; 2694 të dt 13.08.2018, në rastin konkret është dokument përmbartues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-ës e cila dispozitë përcakton së: *“dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbartjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bere shkelje të dispozitave të LPP-ës, me rastin e refuzimit prapësimin nuk qëndrojnë.

Në këtë rast Vendimi i lëshuar nga Komisionit të Pavarur Për Miniera dhe Minerale (KPM), me nr.2694 i datës 13.08.2018 është dokument përmbartimor dhe i përmbartueshëm dhe cilësia e tillë i është konfirmuar me klauzolën e formës së prerë të datës 08.11.2018 dhe klauzolën e ekzekutueshmërisë të datës 24.11.2018 dhe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbartim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e borxhit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbartjes së detyrimit nga ana e debitorit. Po ashtu vendimi si dokument përmbartimor, ka cilësinë e titullit ekzekutiv dhe është i përmbartueshëm, pasi që i njëjti është i

pajisur me klauzolën e formës së prerë dhe klauzolën për ekzekutueshmëri dhe si i tillë konform nenit 36 paragraf 1 dhe 2 të LPP-së, sipas këtij titulli përmbarimi në këtë rast është i lejuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet për mosplotësimin e kushteve për lejimin e përmbarimit sepse gjykata apo përmbaruesi privat në procedurë përmbarimore i përmbahet parimit të rigorozitet formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata-përmbaruesi privat e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarimore, vlerëson nëse janë plotësuar kushte për nxjerrjen e urdhrit përmbarimor dhe në procedurën sipas prapësimit gjykata e shkallës së parë i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE - DHOMA E SHKALLËS SË DYTË  
K.DH.SH.II.nr.428/22, data 26.09.2022

Gjyqtarja

Franciska Zhitija-Ymeri